

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	01.06.2023	viti god year	3
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SYPN/HK	4567/2023		1/5



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.644/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.644/2023, të datës 18.04.2023 të ankueses . , me adrese banimi: Rruga . Komuna e Deçanit, kundër Vendimit Nr.Prot:01-112/01-0026064/2023 të Komisionit të Pranimit të datës 21.03.2023, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.06.2023, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.644/2023 e datës 18.04.2023 e parashtuar nga ankuesja .
- II. Shfuqizohet Njoftimi për Rezultatet përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm i datës 21.03.2023, ndërsa Anulohet në tërsi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 21.12.2022 me numër të Referencës: RN00010693 për emrin e grupit “Specialist i Administrimit të Përgjithshëm”, për një (1) pozitë: “Zyrtar për Gjendje Civile 1”
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi _____ e cila sipas shkresave të lëndës është candidate në procedurën e rekrutimit "Specialist i Administrimit të Përgjithshëm" të shpallur nga Komuna e Pejës, me datë 14.04.2023 pas orarit zyrtar të punës nëpërmjet adresës zyrtare elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 18.04.2023 dhe është protokolluar me numër 3617/2023, Vendimit Nr.Prot:01-112/01-0026064/2023 të Komisionit të Pranimit të datës 21.03.2023 të Komunës së Pejës lidhur me shpalljen rezultateve përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Komisioni i Pranimit ka zbatuar gabimisht dispozitat a aplikuar ligjore me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit në fazën e intervistimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Pejës. Ndërsa me datë 22.11.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 14.04.2023 parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 14.04.2023 dhe 18.04.2023 të dërguar nga ankuesja në Këshill; Vendimit Nr.Prot:01-112/01-0026064/2023 të Komisionit të Pranimit të datës 21.03.2023; E-mailin e datës 31.12.2022 dërguar nga E.C për ankuesen; E-mailin e datës 24.02.2023 dërguar nga SIMBNJ për ankuesen; E-mailin e datës 04.03.2023 dërguar nga P.B për ankuesen; E-mailin e datës 22.03.2023 dërguar nga P.B për ankuesen; E-mailin e datës 24.02.2023 dërguar nga SIMBNJ për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.04.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 10.05.2023; Konkursin e datës 29.12.2022; Vendimin e datës 07.02.2023 të Kryetarit të Komunës; Akt emërimin e datës 01.08.2022; Akt emërimin e datës 01.01.2012; Akt emërimin e datës 04.01.2012; Akt emërimin e datës 04.01.2012 për nëpunësin M.L-K; Marrëveshjen e datës 31.05.2022; Listën aplikantëve; Aplikacionin e ankueses të datës 22.01.2023; Diplomën e ankueses të datës 09.09.2019; Diplomën e ankueses të datës 24.10.2022 me numër:1024; Çertifikatën e datës 25.11.2022; Çertifikatën e datës 01.10.2022; Çertifikatën e datës 25.04.2022 Çertifikatën e datës 29.10.2021; Çertifikatën e datës 25.03.2022; Çertifikatën e datës 25.02.2022; Çertifikatën e datës 24.09.2021; Çertifikatën e datës 18.05.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Njoftimin e datës 06.02.2023; Formularin e Renditjes përfundimtare i datës 21.03.2023; Njoftimin për rezultatin përfundimtar i datës 21.03.2023; Rezultati përfundimtar i datës 06.03.2023; Ankesën e ankueses të parashtruar në Komisionin e Pranimit; Formularin e vlerësimit në mënyrë individuale nga anëtarët e komisionit; Zarin Postar me shifër R5338240.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____ është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka

konstatuar se Komuna e Pejës me datë 29.12.2022 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit të pranimit (i jashtëm) për emrin e grupit “*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*” me numër të Referencës: RN00010693, për një (1) pozitë, si vijon: “*Zyrtar për Gjendje Civile 1*” ndërsa bazuar në aplikacionin e ankuesit të datës 22.01.2023 konstatohet fakti se ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër të Referencës: RN00010693. Ndërsa përveç ankuesit, në këtë procedurë të rekrutimit kishin aplikuar gjithsejtë shtatëdhjetë e gjashtë (76) kandidatë, prej tyre pas fazë së verifikimit paraprak dhjetë (10) kandidatëve iu është refuzuar aplikacioni në këtë fazë për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të konkursit.

Ankuesja, pas shpalljes së rezultatit përfundimtare nga Njësia e Burimeve Njerëzore me datës 06.03.2023, kishte parashtruar ankesë brendshme duke i kontestuar rezultatet përfundimtare me arsyetimin se e njëjta nuk është ftuar në fazën e intervistimit edhe pse pas kalimit të testit me shkrim dhe vlerësimit të jetëshkrimit kishte realizuar 66 pikë dhe se e njëjta i plotësonte kriteret të vazhdoj tutje për intervistim, ndërsa Komisioni i Pranimit përmes Vendimit Nr.Prot:01-112/01-0026064/2023 të datës 21.03.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses ndërsa kishte lënë në fuqi vlerësimet përfundimtare të kandidatëve, kështu që pas përfundimit të fazës së ankesave të brendshme, Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 21.03.2023 nxjerr rezultat përfundimtar lidhur me kandidatët e suksesshëm për pozitën e shpallura të konkursit nga rezultoni se ankuesja nuk ishte në mesin kandidatëve të suksesshëm.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin e shpallur të datës 21.12.2022, për grupin “*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*” me numër të Referencës: RN00010693 për një (1) pozitë, si vijon: “*Zyrtar për Gjendje Civile 1*” e shpallura nga Komuna e Pejës, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve Universitare me të paktën 180, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik, Fakulteti i Administratë Publike apo Fakulteti i Biznesit-Ekonomik,*
- *Përvoja e punës: Nuk kërkohet.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me kërkesën e tij për anulimin e konkursit për shkak të vlerësimeve se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të tij ka vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara, me qëllim shqyrtimit të ligjshmërisë të procedurës së rekrutimit, që prej momentit të shpalljes së konkursit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil neni 27 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: “*Për qëllim të organizimit të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës pozitave të kategorisë profesionale grupohen sipas natyrës të pozitës në: 1.2. grupin e pozitave të administrimit të përgjithshëm. 3. Grupi i pozitave të administrimit të përgjithshëm përfshin të gjitha pozitave që nuk janë pjesë e një grupi të administrimit të posaçëm dhe që kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësi, të përgjithshme administrative, kryerja me sukses e të cilave kërkon njohuri dhe aftësi të përgjithshme administrative, të cilat nuk burojnë apo lidhen domosdoshmërisht me zotërimin e një ose disa profesioneve të caktuara*” ndërlidhur me Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, renditja numër 58 e Grupit- Specialist i Administrimit të Përgjithshëm **Arsim i lartë i paspecifikuar**, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komuna e Pejës me rastin e shpalljes së konkursit të datës

21.12.2022, me numër të Referencës: RN00010693, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material lidhur me përcaktimin e kriterëve të kualifikimeve profesionale, pasi që për grupin e pozitave "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" kërkohet vetëm arsimimi i lartë dhe nuk është i specifikuar, ndërsa në konkursin e kontestuar kanë qenë të përcaktuar si kriterë, apo kualifikime të posaçme formale: *Fakulteti Juridik, Fakulteti i Administratë Publike apo Fakulteti i Biznesit-Ekonomik*, ndërsa çështja e kriterëve të posaçme formale në kuptim të Rregullore Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil rregullon tjetër çështje dhe ka të bëjë me Çertifikata apo Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitë e kësaj klase, kurse institucioni gjegjësisht Komuna e Pejës me asnjë shkresë të lëndës nuk e ka arsyetuar faktin e vendosjes së kriterëve shtesë për plotësimin e kualifikimeve të posaçme formale, e që në rastin konkret nuk janë ekuivalente me certifikata apo licenca.

Bazuar si më lartë, nga shkresat e administruara të lëndës si dhe gjetjeve të shkeljeve të rregullave dhe parimeve të pranimit në shërbimin civil lidhur me përcaktimin e kriterëve të konkursit të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se Komuna e Pejës me rastin e shpalljes së konkursit të pranimit (i jashtëm) të datës 21.12.2022 për emrin e grupit "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" me numër të Referencës: RN00010693, për një (1) pozitë, si vijon: "*Zyrtar për Gjendje Civile 1*", ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "*1. Pranimi në detyrë i nëpunësit Civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.*", pasi që me rastin e shpalljes së konkursit kishte përcaktuar kriteret e përgjithshme formale ndërlidhur me kualifikimet e posaçme formale në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, andaj mbi këtë Kolegji i Këshillit njëzëri ka vendosur që procedura e kontestuar përmes kësaj ankese të anulohet në tërësi, gjegjësisht Njoftimi i rezultatit përfundimtar për kandidatët e suksesshëm i datës 21.03.2023 është shfuqizuar, ndërsa Konkursi i shpallur me datë 21.12.2022, për grupin "*Specialist i Administrimit të Përgjithshëm*" me numër të Referencës: RN00010693 është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga se u tha më lartë, meqenëse është konstatuar se me rastin e hapjes së konkursit të kontestuar me këtë ankesë Komuna e Pejës nuk ka përfillur parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, pasi që ishin vendosur kriterë të cilat nuk përcaktohen me legjislacionin në fuqi për kualifikimit e posaçme formale, Kolegji i Këshillit ka vendosur njëzëri se ky fakt përbën bazë të mjaftueshme ligjore që konkursi të anulohet në tërësi, ndërsa Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në shqyrtim e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses për asnjë fazë tjetër të rekrutimit apo veprim procedural, pasi që nuk do të kishte asnjë efekt të ndryshëm juridik, ngase në rastin konkret, janë konstatuar shkelje të parimeve të përgjithshme në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.644/2023

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Pejës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës, dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

